“Nëse dikush ndien diç (gazra) në bark, gjë që i ngjall dyshime nëse ka lëshuar ndonjë gaz apo jo, assesi të mos dalë nga xhamia pa dëgjuar zë ose pa ndier erë.”

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Nëse dikush ndien diç (gazra) në bark, gjë që i ngjall dyshime nëse ka lëshuar ndonjë gaz apo jo, assesi të mos dalë nga xhamia pa dëgjuar zë ose pa ndier erë.”
[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se, nëse diçka lëviz në barkun e namazliut dhe ai është në dyshim, a ka dalë diçka prej tij apo jo, nuk duhet të largohet nga namazi e ta ndërpresë për ta përsëritur abdesin, derisa të sigurohet se ka bërë ndonjë veprim që ia prish abdesin: duke dëgjuar zhurmën e gazrave ose duke e nuhatur erën, sepse gjënë e sigurt nuk e zhvleftëson dyshimi. Në fakt, ai është i sigurt për pastërtinë (se ka abdes), ndërsa prishja e abdesit është dyshimtë.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/65083